

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
VITI 2026

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Natyra e kërimit	Objekti i kërkesës (përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Përgjigje (përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Data e kthimit të përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (përgjigjja jepet e plotë / e kufizuar / e deleguar)	Tarifa
110.	04.08.2026	Kërkesë për informacion	Në kuadër të një importi të planifikuar të produktit ushqimor “<i>Matcha Tea</i>”, me origjinë nga Japonia, subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me raportin e analizës së mbetjeve të pesticideve të lëshuar nga një laborator i akredituar sipas standardit ISO/IEC 17025. Konkretisht, produkti i analizuar si “<i>tea leaves</i>” ka të evidentuar në raport, këto substanca: • Dinotefuran – 0.41 mg/kg; • Ethiprole – 0.02 mg/kg; • Silafluofen – 0.02 mg/kg; • Tolfenpyrad – 0.04 mg/kg; • Fluxametamide – 0.01 mg/kg. Nga shqyrtimi i Udhëzimit nr.17, datë 25.04.2025 “<i>Mbi nivelet maksimale të mbetjeve të</i>	Çdo pesticid ka MRL (mg/kg) e tij, ashtu siç përcaktohet në Udhëzim, dhe në çdo rast, shqyrtohet niveli përkatës në produkt. Lidhur me detektimin, laboratorët e akredituar në BE i referohen metodës analizuese UNI EN ISO 15662, me referencë MRL Regulation (EC) no.396/2005 of the European Parliament and of the Council of 23 February 2005 “<i>On maximum residue levels of pesticides in or on food and feed of plant and animal origin and amending Council Directive 91/414/EEC Text with EEA relevance</i>”. Legjislacioni shqiptar në fuqi, bazohet kryesisht në Udhëzimin nr.17, datë 25.04.2025 “<i>Mbi nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ushqimet dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore dhe shtazore</i>”, pjesërisht i përafëruar me Rregulloren (BE) no.396/2005, të datës 23 Shkurt 2025, mbi nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ose mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë me origjinë bimore dhe shtazore dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/414/KEE.	17.08.2026	e plotë	nuk ka

		pesticideve në ushqimet dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore dhe shtazore”, për kategorinë 0610000 – Çajra, rezulton se për disa prej këtyre substancave nuk identifikohet në tabelë një nivel maksimal numerik i përcaktuar posaçërisht për çajin, ndërsa për <i>Dinotefuranin</i> edhe pse parashikohet në tabelë nuk rezulton qartë një vlerë numerike e zbatueshme. Për këtë arsye, subjekti kërkon të informohet se: 1. Cili kriter ose nivel maksimal zbatohet për një substancë pesticide për të cilën Udhëzimi nr.17/2025 nuk përcakton MRL numerike për kategorinë “Çajra”? 2. A zbatohet në këto raste një kufi i përgjithshëm, për shembull 0.01 mg/kg, apo kryhet një vlerësim individual i riskut? 3. A përdoren nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si kriter teknik ose referues, MRL-të e përcaktuara nga Rregullorja (KE) nr.396/2005, kur nuk ekziston një kufi i posaçëm në legjislacionin shqiptar? 4. A mund të konsiderohen të pranueshme për import nivelet	Vlerësimi shkencor i riskut kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Ky i fundit, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për inspektimin në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) në fushën e sigurisë ushqimore, ushtron veprimtarinë e tij duke u mbështetur në ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në fuqi. Këto akte nënligjore përcaktojnë parimet, procedurat dhe mekanizmat mbi bazën e të cilave realizohen kontrollet zyrtare në Kufi, me qëllim garantimin e shëndetit publik dhe mbrojtjen e konsumatorit. Për kryerjen e importit në Republikën e Shqipërisë, zbatohen kërkesat e Urdhrit nr.374, datë 31.08.2017 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.72, datë 15.3.2011, për më tepër “Për miratimin e Akt – Kontrollit “Mbi inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore në Pikat e Inspektimit Kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre” dhe Akt-“Marrje Mostre” për produktet me origjinë jo shtazore të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë. Produkte të tilla, shoqërohen me dokumentacionin e mëposhtëm: – Certifikatë e vendit të origjinës; – Raport Analizë për produktin; – Faturë. Gjatë procedurës së importit apo gjatë tregtimit, nga ana e trupës inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit merren mostra të cilat dërgohen për analizim pranë Laboratorit të			
--	--	--	--	--	--	--

			e evidentuara në raport për <i>Dinotefuranin, Ethiprole, Silafluofen, Tolfenpyrad dhe Fluxametamide?</i> 5. Cili institucion ose strukturë kryen vlerësimin shkencor të riskut për këto substanca dhe çfarë dokumentacioni duhet të paraqesë importuesi? 6. A kërkohet një analizë shtesë nga Laboratori ISUV ose nga një laborator tjetër i njohur nga autoritetet shqiptare, përpara ose gjatë procedurës së importit? 7. A mund të paraqitet paraprakisht për shqyrtim raporti laboratorik i bashkëlidhur, përpara nisjes së ngarkesës nga Japonia? <i>Lutemi që përgjigjja të përmbajë, nëse është e mundur, edhe referencën konkrete ligjore ose nënligjore mbi të cilën mbështetet praktika e ndjekur nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në këto raste.</i>	akredituar “ISUV”, duke u bazuar në <i>Planin Vjetor me bazë risku dhe të marrjes së mostrave</i>, në raste monitorimi apo emergjence. Laboratori i Referencës Kombëtare “ISUV”, në laboratorin e mbetjeve të produkteve me origjinë bimore, analizon me metodën analitike CEN-EN 15662 - Foods of plant origin - Multimethod for the determination of pesticide residues using GC-based analysis following acetonitrile extraction/partitioning and clean-up by dispersive SPE-Modular QuEChERS- method, në zbatim të Udhëzimit nr.17, datë 25.04.2025 dhe nuk vlerëson analitët të cilët nuk kanë MRL në këtë udhëzim, me një pasiguri në matje = $\pm 50\%$ dhe vlera ≤ 0.01 i referohet limitit të përcaktimit sasiar të metodës. Të gjitha testet që lëshohen në Raport Proven e Laboratorit “ISUV”, janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).			
--	--	--	--	--	--	--	--

111.	04.08.2026	Kërkesë për informacion <i>(vijim komunikimi lidhur me kërkesën nr.109 – referohu Regjistrin të kërkesave & kthim-përgjigjeve Korrik 2026)</i>	Në vijim të përgjigjes së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, lidhur me masat e marra ndaj shoqërisë “R**L**” SHPK, subjekti i interesuar kërkon informacion: 1. Për pesë rastet kur shoqëria “R**L**” është paralajmëruar të marrë masa për asgjësimin e produkteve, cilat ishin produktet, lotet, sasi të njësitë tregtare ku u konstatuan dhe arsyet konkrete të asgjësimit? 2. Çfarë veprimesh ka ndërmarë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pas dhënies së këtyre paralajmërimeve për të ndjekur zbatimin e tyre? Lutem të bëhen të ditura afatet e vendosura, ri-inspektimet e kryera dhe gjendja aktuale e secilës procedurë. 3. A janë mbajtur produktet të bllokuara deri në përfundimin e procedurës dhe ku ndodhen aktualisht sasi të që nuk janë asgjësuar ende? 4. A e ka njoftuar shoqëria “R*L*”, Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për nisjen e procedurave të asgjësimit? Nëse po, në cilat data dhe për cilat produkte? A kanë marrë	Nga verifikimet e fundit të kryera nga strukturat përkatëse, ka rezultuar se për shkak të një pasaktësie të krijuar në <i>sistemin e të dhënave</i>, informacioni i përcjellë më herët (ref.: Kërkesa nr.109 në Regjistrin e kërkesave dhe kthim përgjigjeve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, muaji Korrik 2026), përmban një pasaktësi, për të cilën sqarojmë se: Nga verifikimet e kryera, rezulton se masat administrative të marra ndaj subjektit “R**L**” SHPK, në vitin 2026, janë në total <u>21</u> (njëzet e një) masa administrative “Gjobë” me vlerë totale prej ALL 2,200,000 (dy milion e dyqind mijë lekë), për arsyet: 19 (nëntëmbëdhjetë) masa për mungesë të gjurmueshmërisë dhe 2 (dy) masa për përgjegjësitë e operatorit. <i>Në vijim të trajtimit të kërkesës për informacion nga subjekti i interesuar, informojmë sa më poshtë vijon.</i> <i>Në përgjigje të pyetjes së parë,</i> masat administrative “Paralajmërim” janë marrë: • Njësia “R**” Fier me objekt verifikimi i njoftimit të ardhur nga sistemi RASFF është lënë masa me “Paralajmërim” për mos evidentimin e sistemit të gjurmueshmërisë sipas kërkesave të VKM-së nr.760 për gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore; • Në 4 (katër) rastet “R**” njësia qendrore, janë konstatuar produkte referuar njoftimeve të ardhura në sistemin RASFF, njoftim nga OBU, njoftim nga info@aku.gov.al, si dhe referuar njoftimit të dërguar nga DPAKU, më konkretisht për produktet:	17.08.2026	e plotë	nuk ka
------	------------	--	--	---	------------	---------	--------

			pjesë përfaqësuesit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në ndonjë procedurë asgjësimi dhe a janë hartuar procesverbalet përkatëse? 5. Për 18 (tetëmbëdhjetë) masat e vendosura për mungesë gjurmueshmërie, lutem të na informoni mbi datën e inspektimit, njësinë tregtare, produktin ose kategorinë e produktit, shkeljen e konstatuar dhe nëse shoqëria “R*L*”ka provuar korrigjimin e saj brenda afatit të vendosur. 6. Në rastet kur subjekti nuk ka zbatuar paralajmërimin për asgjësim ose nuk ka korrigjuar mangësitë e gjurmueshmërisë, çfarë masash të mëtejshme administrative ka ndërmarre Autoriteti Kombëtar i Ushqimit? <i>Kërkesa nuk përfshin të dhëna personale të inspektorëve, punonjësve, konsumatorëve apo personave të tjerë fizikë. Çdo e dhënë e tillë mund të anonimizohet, pa cenuar informacionin mbi produktet, lotet, sasinë, njësinë tregtare, afatet dhe masat e marra.</i>	• Në total bllokuar 0.036 ton (Beba pre 800g me nr loti 51250346AA me datë skadence 05.2027 në sasinë 10 copë/Beba pre 800g me nr loti 51720346AA me. datë skadence 06.2027 në sasinë 4 copë/Beba pre 800g me nr loti 51660346AC me datë skadencë 06.2027 në sasinë 288 copë/Beba 1, 800g me nr loti 51180346AB me datë skadence 04.2027 në sasinë 27 copë/Beba 1, 800g me nr loti 51450346AA me datë skadence 05.2027 në sasinë 120 copë/ .Beba 1, 800g me nr loti 51660346AB me datë skadence 06.2027 në sasinë 270 copë/Beba supreme pre 800g me nr loti 51720742F3 me datë skadence 06.2027 në sasinë 48 copë/ .Beba supreme 2, 800g me nr loti 51550742F1/ Beba supreme me datë skadence 06.2027 në sasinë 14 copë 2, 800g me nr loti 51550742F2 me datë skadence 06.2027 në sasinë 10 copë; • Në total bllokuar sasia 0.0544 ton (Beba Supreme pre 800g me datë skadence 6/5/2024 me numër barkodi 761328 7226631); • Në total 0.679 ton (Aptamil l pronutrat 800 gr advance 15 copë (12 kg) me datë skadence 03.11.2026 2. Aptamil pre profutura duo advance 800 gr, 106 copë (84.8 kg) - 39 copë me datë skadence 06. 08.2027, NIPT ***** - 8 copë me datë skadence 08.05.2027, - 8 copë me datë skadence 11.02.2027, -9 copë me datë skadence 17.09.2027, -42 copë me datë skadence 08.06.2027. 3. Aptamil 2 pronutrat 800 gr 326 copë (260.8 kg) me datë skadence 09.01.2027 4. Aptamil 3 pronutrat 800 gr 5 copë (4 kg) - 3 copë me datë skadence 18.12.2026 -1 copë			
--	--	--	---	---	--	--	--

			me datë skadence 30.08.2026 - 1 copë me datë skadence 29.11.2026 5. Aptamil 1 profutura duo advance 800 gr, 72 cope (57.6 kg) - 32 copë me datë skadence 08.08.2027 - 40 copë me datë skadence 27.09.2027 6. Aptamil 2 profutura duo advance 800 gr, 285 copë (228 kg) 182 copë me datë skadence 11.11.2027 -1 copë me datë skadence 10.02.2027 Datë 06/02/2026 -9 copë me datë skadence 18.05.2027 -22 copë me datë skadence 05.08.2028 - 8 copë me datë skadence 04.08.2027 -7 copë me datë skadence 14.06.2027 - 56 copë me datë skadence 02.11.2027 7. Aptamil pronutra pre advance 800 gr, 40 cope (32 kg) -2 copë me datë skadence 04.12.2026 -6 copë me datë skadence 23.07.2026 -3 copë me datë skadence 10.11.2026 -5 copë me datë skadence 14.10.2026 24 copë me datë skadence 18.11.2026); • Në total sasia 0.0026 ton (Enerbio Dinkel Waffeln Natur 115g). <i>Në përgjigje të pyetjes së dytë</i>, në të katër rastet e cituara më lart, janë kryer procedurat e asgjësimit të produkteve ushqimore të bllokuara nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Afatet e përcaktuara për kryerjen e procedurave të asgjësimit të produkteve ushqimore janë zbatuar në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.			
--	--	--	--	--	--	--

			Në vijim të ndjekjes së procedurës nga OBU-ja, në zbatim të përcaktimeve të nenit 69 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar), ku citohet se: “<i>Bllokimi dhe asgjësimi i ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Ushqimi dhe ushqimi për kafshë, që nuk plotëson kërkesat e këtij ligji dhe që është bllokuar ose hequr nga tregu, asgjësohet me procesverbal të rregullt, sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe shpenzimet përballohen nga operatori i biznesit ushqimor ose operatori i biznesit të ushqimit për kafshë, që ka bërë shkeljen</i>”, është bërë kërkesë për asgjësim pranë DRAKU-së përkatëse, ku dhe është kryer procedura e asgjësimit të produkteve të bllokuara. <i>Në përgjigje të pyetjes së tretë</i>, në zbatim të nenit 46 të ligjit nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, produktet mbahen të bllokuara pranë ambienteve të subjektit dhe, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar), ku citohet se: “<i>Bllokimi dhe asgjësimi i ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Ushqimi dhe ushqimi për kafshë, që nuk plotëson kërkesat e këtij ligji dhe që është bllokuar ose hequr nga tregu, asgjësohet me procesverbal të rregullt, sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe shpenzimet përballohen nga operatori i biznesit ushqimor ose operatori i biznesit të ushqimit për kafshë, që ka bërë shkeljen</i>”, paraqet kërkesën pranë DRAKU-së përkatëse për kryerjen e procedurës së asgjësimit të produkteve të bllokuara.			
--	--	--	--	--	--	--

Sqarojmë se procedurat e asgjësimit të produkteve për tre rastet e para janë kryer, ndërsa, për rastin e katërt, produkti vazhdon të qëndrojë i bllokuar deri në marrjen e masave për asgjësim.

Në përgjigje të pyetjes së katërt, sikurse më lart përmendur, asgjësimi i produkteve për tre rastet e para është kryer më datë 04.05.2026, ndërsa, për rastin e fundit (*në total, sasia 0.0026 ton, Enerbio Dinkel Waffeln Natur 115g*), produkti vazhdon të qëndrojë i bllokuar në ambientet e subjektit, deri në marrjen e masave për asgjësim, në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi.

Në përgjigje të pyetjes së pestë, informacioni i kërkuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Masa administrative “Gjobë”				
Janar 2026 data:	DR AKU	Adresa e subjektit	Vlera ('000 lekë)	Arsyeja e masës
29	Lezhë	Lezhë	100	Mungesë gjurmueshmërie
29	Korçë	Korçë	100	Mungesë gjurmueshmërie
09	Tiranë	Rr."Bashkim Shkurti", Kashar	200	Mungesë gjurmueshmërie / Përgjegjësitë e operatorit
29	Tiranë	Rr."Bashkim Shkurti", Mëzez	300	Mungesë gjurmueshmërie / Përgjegjësitë e operatorit
29	Tiranë	Rr."5 Maji", Qendra "Emerald"	100	Mungesë gjurmueshmërie
29	Tiranë	Rr."Sotir Caci", Dajt	100	Mungesë gjurmueshmërie
29	Tiranë	TEG, Rr.Nacionale Tiranë-Elbasan	100	Mungesë gjurmueshmërie

				<table><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Njësia Nr.9, Rruga e Barrikadave</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr."Mine Peza", Tiranë</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr."Xhanfize Keko"</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr. e Kavajës, Condord Center</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr. e Kavajës, Garden Building</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr."Ali Demi", Tiranë</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Kashar, Rr."Vasil Tromara"</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr."Esat Mekuli", ish-Fusha e Aviacionit</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr Muhamet Gjollës, Tirana Ring Center</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>QTU, Kashar</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Qendra "Kristal", Tiranë</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr><tr><td>29</td><td>Tiranë</td><td>Rr."Kristo Luarasi"</td><td>100</td><td>Mungesë gjurmueshmërie</td></tr></table>	29	Tiranë	Njësia Nr.9, Rruga e Barrikadave	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr."Mine Peza", Tiranë	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr."Xhanfize Keko"	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr. e Kavajës, Condord Center	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr. e Kavajës, Garden Building	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr."Ali Demi", Tiranë	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Kashar, Rr."Vasil Tromara"	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr."Esat Mekuli", ish-Fusha e Aviacionit	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr Muhamet Gjollës, Tirana Ring Center	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	QTU, Kashar	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Qendra "Kristal", Tiranë	100	Mungesë gjurmueshmërie	29	Tiranë	Rr."Kristo Luarasi"	100	Mungesë gjurmueshmërie			
29	Tiranë	Njësia Nr.9, Rruga e Barrikadave	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr."Mine Peza", Tiranë	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr."Xhanfize Keko"	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr. e Kavajës, Condord Center	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr. e Kavajës, Garden Building	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr."Ali Demi", Tiranë	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Kashar, Rr."Vasil Tromara"	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr."Esat Mekuli", ish-Fusha e Aviacionit	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr Muhamet Gjollës, Tirana Ring Center	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	QTU, Kashar	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Qendra "Kristal", Tiranë	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
29	Tiranë	Rr."Kristo Luarasi"	100	Mungesë gjurmueshmërie																																																															
Po kështu, nga verifikimi i historikut të inspektimeve, rezulton se subjekti ka kryer korrigjimin e shkeljeve të konstatuara. <i>Në përgjigje të pyetjes së fundit</i>, rezulton se në total janë evidentuar 3 (tre) raste në të cilat janë marrë masa me paralajmërim për asgjësimin e produkteve.																																																																			

				Nga ndjekja e këtyre masave rezulton se, në të tre rastet, është kryer asgjësimi i produkteve, në përputhje me masat e vendosura nga strukturat inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Ndërkohë, 1 (një) rast vijon të jetë i bllokuar në ambientet e subjektit dhe masa e bllokimit të produkteve është në fuqi deri në përfundimin e procedurave dhe marrjen e masës përfundimtare të asgjësimit, sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket mangësive të konstatuara në sistemin e gjurmueshmërisë, nga verifikimi i historikut të inspektimeve të kryera në subjekt rezulton se mangësitë e evidentuara lidhur me sistemin e gjurmueshmërisë janë korrigjuar nga subjekti dhe janë adresuar në vijim të kontrolleve të kryera nga strukturat e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.			
112.	12.08.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me procedurat e ndërprerjes së importit të mishit nga Republika Federale e Brazilit pas datës 3 Shtator 2026, konkretisht: 1. Në cilën datë zyrtare u njoftua për herë të parë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit mbi hartimin, diskutimin apo miratimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2026/1189? 2. Rregullorja e mësipërme e BE-së është publikuar më datë 04 Qershor 2026. Përse njoftimi i bizneseve importuese nga ana e	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është institucioni përgjegjës për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (VKM, Urdhra/Udhëzime të Ministrit, etj.). <i>Për sa i përket pyetjes së parë të parashtruar</i>, lidhur me datën e njoftimit zyrtar të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për hartimin, diskutimin apo miratimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2026/1189, sqarojmë se është Autoriteti Kompetent Qendror (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) i cili ka detyrim ligjor për nxjerrjen e akteve nënligjore apo njoftimin e institucioneve të varësisë lidhur me ndryshimet ligjore apo rregulloret zbatuese të Komisionit (BE), të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në procedurat e importit, me qëllim garantimin e Sigurisë Ushqimore.	24.08.2026	e plotë	nuk ka

		Autoritetit Kombëtar të Ushqimit u krye vetëm në muajin Gusht 2026? Cilat ishin arsyet e kësaj vonese dy-mujore? 3. Sa është sasia totale (e shprehur në ton) e mishit të gjedhit dhe mishit të shpendëve të importuar nga Brazili në Shqipëri, për periudhën 4 Qershor 2026 deri më sot? 4. Sa ka qenë importi (në ton) i mishit të gjedhit dhe shpendëve nga Brazili për të njëjtën periudhë kohore (4 Qershor – Gusht) përgjatë vitit 2025? 5. Sa ton mish nga Brazili ka hyrë gjithsej në Shqipëri gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2024, 2025 dhe pjesa e mbetur e vitit 2026), e ndarë sipas viteve dhe llojit të mishit? 6. Çfarë do të ndodhë me ngarkesat e mishit brazilian që kanë hyrë apo do të hyjnë në Shqipëri para datës 3 Shtator 2026? A do të lejohet shitja dhe konsumi i këtij stoku pas kësaj date, apo do të tërhiqet nga tregu? 7. Çfarë medikamentesh veterinarë (hormone, rritës mase muskulare, antimikrobikë specifikë) janë përdorur në Brazil që shërbyen si shkak për bllokimin e BE-së? Çfarë	Për sa më sipër sqaruar, <i>në përgjigje të pyetjes së dytë</i>, duke qenë se nga publikimi i kësaj Rregulloreje e deri më datë 24 Korrik 2026, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk dispononte asnjë Urdhër/Udhëzim apo orientim nga Autoriteti Kompetent Qendror lidhur me zbatimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2026/1189, i jemi drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me një “<i>Kërkesë lidhur me vijimin e procedurave në Pikat e Inspektimit Kufitar për importin e mishit të gjedhit dhe mishit të shpendëve nga Brazili</i>”. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka sqaruar se: “<i>Për sa kohë që Urdhri i Ministrit nr.294, datë 13.06.2006, e kushtëzon importin me miratimin nga Bashkimi Evropian të zonave dhe stabilimenteve të prodhimit, ndryshimet e sjella me Rregulloren Zbatuese (BE) 2026/1189 reflektohen drejtpërdrejt në zbatimin e këtij Urdhri</i>”, duke urdhëruar gjithashtu Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, për njoftimin e subjekteve. <i>Në përgjigje të pyetjes së tretë</i>, nga verifikimet e kryera, rezulton se për periudhën 04 Qershor e deri më sot, janë importuar në total 82 (<i>tetëdhjetë e dy</i>) ngarkesa me sasi totale 2146.026 ton, nga të cilat: • 56 (<i>pesëdhjetë e gjashtë</i>) ngarkesa me mish pule, në sasinë 1453.222 ton; • 2 (<i>dy</i>) ngarkesa me mish gjedhi, në sasinë 53.078 ton; dhe • 24 (<i>njëzet e katër</i>) ngarkesa me mish derri, në sasinë 639.726 ton.			
--	--	---	--	--	--	--

		rreziqesh shëndetësore paraqesin këto substanca për konsumatorët? 8. Gjatë 5 (<i>pesë</i>) viteve të fundit, sa herë ka patur sinjalizime (nga sistemi RASFF i BE-së apo nga kontrollet e vetë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit) për mospërmbushje të standardeve ose prani të substancave të ndaluara në mishin e importuar nga Brazili? 9. A ka patur raste të bllokimit apo kthimit mbrapsht të ngarkesave me mish nga Brazili në pikat e inspektimit kufitar (PIK) shqiptar gjatë kësaj periudhe? Nëse po, në çfarë sasish dhe për çfarë arsyes.	<i>Në përgjigje të pyetjes së katërt</i>, nga verifikimet e kryera, rezulton se përgjatë periudhës Qershor – Gusht 2025, sasia totale e importuar është 103 (<i>njëqind e tre</i>) ngarkesa me sasi totale 2703.986 ton, nga të cilat: • 36 (<i>tridhjetë e gjashtë</i>) ngarkesa me mish pule, në sasinë 953.650 ton; • 4 (<i>katër</i>) ngarkesa me mish gjedhi, në sasinë 100.958 ton; dhe • 63 (<i>gjashtëdhjetë e tre</i>) ngarkesa me mish derri, në sasinë 1649.378 ton. <i>Në përgjigje të pyetjes së pestë</i>, rezulton se përgjatë vitit 2024 janë importuar gjithsej 512 (<i>pesëqind e dymbëdhjetë</i>) ngarkesa nga Brazili, me sasi totale 13409.178 ton, nga të cilat: • 235 (<i>dyqind e tridhjetë e pesë</i>) ngarkesa me mish pule, në sasinë 6265.650 ton; • 34 (<i>tridhjetë e katër</i>) ngarkesa me mish gjedhi, në sasinë 691.359 ton; dhe • 243 (<i>dyqind e dyzet e tre</i>) ngarkesa me mish derri, në sasinë 6452.170 ton. Përgjatë vitit 2025, rezulton se janë importuar gjithsej 475 (<i>katërqind e shtatëdhjetë e pesë</i>) ngarkesa nga Brazili, me sasi totale 12522.47 ton, nga të cilat: • 254 (<i>dyqind e pesëdhjetë e katër</i>) ngarkesa me mish pule, në sasinë 6727.1651 ton; • 23 (<i>njëzet e tre</i>) ngarkesa me mish gjedhi, në sasinë 571.432 ton; dhe • 198 (<i>njëqind e nëntëdhjetë e tetë</i>) ngarkesa me mish derri, në sasinë 5223.878 ton.			
--	--	---	--	--	--	--

				Ndërsa, përgjatë vitit 2026, rezulton se deri më tani janë importuar 344 (<i>treqind e dyzet e katër</i>) ngarkesa nga Brazili, me sasi totale 9312.619 ton, nga të cilat: • 207 (<i>dyqind e shtatë</i>) ngarkesa me mish pule, në sasinë 5,432.121.650 ton; • 11 (<i>njëmbëdhjetë</i>) ngarkesa me mish gjedhi, në sasinë 272.186 ton; dhe • 126 (<i>njëqind e njëzet e gjashtë</i>) ngarkesa me mish derri, në sasinë 3608.311 ton. <i>Në përgjigje të pyetjes së gjashtë</i>, në vijim të komunikimit që Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pati me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i jemi drejtuar këtyre të fundit me një kërkesë tjetër për informacion, se: “<i>Si do të trajtohen ngarkesat e certifikuara dhe/ose të nisura përpara datës 03 Shtator 2026, por që mbërrijnë në Republikën e Shqipërisë pas kësaj date?</i>”. Lidhur me këtë pyetje, Ministria ka sqaruar se: Më datë 28 Maj 2026, në Bruksel është zhvilluar një takim ndërmjet përfaqësuesve të UECBV (Bashkimi Evropian i Tregtisë së Blegtorisë dhe Mishit) dhe DG SANTE, ku nga përfaqësuesit e Komisionit është sqaruar se: “<u>Ngarkesat për të cilat certifikata është lëshuar përpara datës 03 Shtator 2026 do të vijojnë të pranohen në Pikat e Kontrollit Kufitar (BCP) të BE-së, pasi kërkesat nuk zbatohen për eksportet nga vendet e treta përpara kësaj date</u>”.			
--	--	--	--	---	--	--	--

			Në përputhje me këtë sqarim, <u>ngarkesat e mishit të shpendëve dhe të gjedhit me origjinë nga Brazili, për të cilat certifikata shëndetësore veterinare zyrtare është nënshkruar/lëshuar përpara datës 03 Shtator 2026, do të vijojnë të pranohen në Pikat e Kontrollit Kufitar, edhe në rast se mbërrijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pas datës 03 Shtator 2026.</u> <i>Lidhur me pyetjen shtatë të parashtruar,</i> sqarojmë se informacioni mbi substancat konkrete, arsyetimin e masës së marrë nga Bashkimi Evropian dhe vlerësimin e rrezikut shëndetësor për konsumatorët është kompetencë e institucioneve përkatëse të Bashkimit Evropian. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit zbaton masat e përcaktuara në aktet përkatëse të BE-së dhe nuk është autoriteti përgjegjës për këtë vlerësim. <i>Në përgjigje të pyetjes së tetë,</i> referuar viteve 2022, 2023 dhe 2024, <u>nuk ka patur sinjalizime nga sistemi “RASFF” për prani të substancave të ndaluara në mishin e importuar nga Brazili apo raste të raportuara nga kontrollet zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.</u> Po kështu, përgjatë vitit 2025, <u>nuk ka patur sinjalizime nga sistemi “RASFF” për prani të substancave të ndaluara në mishin e importuar nga Brazili,</u> por, ka patur 3 (tre) raste të raportuara nga kontrollet dhe mostrat e marra nga ana e trupave inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, konkretisht:			
--	--	--	--	--	--	--

			• <i>Doxycycline</i> në trash kofshë pule, me origjinë nga Brazili; • <i>Salmonella</i> në fileto derri, me origjinë nga Brazili; dhe • <i>Salmonella typhimurium</i> në mish pule nga Brazili. Së fundmi, përgjatë vitit 2026, <u>nuk ka patur sinjalizime nga sistemi “RASFF”</u> për prani të substancave të ndaluara në mishin e importuar nga Brazili, por, ka patur 2 (dy) raste të raportuara nga kontrollet dhe mostrat e marra nga ana e trupave inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, konkretisht: • <i>Doxycycline</i> në mish pule, me origjinë nga Brazili, nëpërmjet SHBA; • <i>Salmonella spp</i> në fileto pule të ngrirë nga Brazili. <i>Në përgjigje të pyetjes së fundit</i>, nga verifikimet e kryera sipas të dhënave të raportuara nga Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, rezulton se: • <i>përgjatë vitit 2024</i>, <u>nuk</u> ka patur raste të kthimit në origjinë; • <i>përgjatë vitit 2025</i>, janë kthyer në total 14 (katërmbëdhjetë) ngarkesa me mish nga Brazili, nga të cilat, 1 (një) ngarkesë për shkak se nuk ishte stabiliment i miratuar për import nga BE dhe 13 (trembëdhjetë) raste të tjera, nga procedurat e marrjes së mostrave në PIK, të cilat kanë rezultuar jokonforme; • <i>përgjatë vitit 2026</i>, <u>nuk</u> ka patur raste të kthimit në origjinë.			
--	--	--	---	--	--	--

113.	19.08.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion <i>lidhur me importin e mishit të shpezëve nga Brazili, pasi Bashkimi Evropian ka ndaluar importin e mishit të shpezëve nga Brazili, duke filluar prej datës 03 Shtator 2026.</i> Konkretisht, subjekti (importues) ka ngarkuar një kontinier përpara datës 03 Shtator 2026, ngarkesë e cila do të zbarkojë në Durrës pas kësaj date, për të vijuar më pas tranzitin në Kosovë. Duke qenë se statusi i këtyre dërgesave mbetet i paqartë, subjekti kërkon informacion për saktësim lidhur me ngarkesat nga Brazili, përpara datës 03 Shtator 2026.	Lidhur me procedurat tranzit për Kosovë të kryera në Portin e Durrësit, për produktet mish pule dhe mish gjedhi me origjinë nga Brazili, informojmë se Autoritetet e Kosovës, konkretisht, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, kryejnë funksionet lidhur me procedurën hyrëse/doganore të Kosovës në ambientet e Portit të Durrësit. Zbatimi i Rregulloreve të Bashkimit Evropian (BE) në Shqipëri lidhet vetëm me importin e mishit të pulës dhe të gjedhit <u>në Shqipëri</u> dhe nuk zbatohet për tranzitin drejt Kosovës.	01.09.2026	e plotë	nuk ka
114.	20.08.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion <i>mbi importet në Republikën e Shqipërisë të produkteve të mishit me vend origjine Brazil, për vitet 2024, 2025 dhe për periudhën e disponueshme të vitit 2026, konkretisht:</i> 1. Sasinë e produkteve të mishit me origjinë nga Brazili që kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të ndarë sipas viteve dhe kategorive: - mish derri - mish gjedhi - mish shpendësh - mish nga të imtat, përfshirë mish deleje dhe dhie;	<i>Në përgjigje të pyetjes së parë,</i> në zbatim të Urdhrit nr.294, datë 13.06.2006 të Ministrit “Për importin e mishit nga Republika Federale e Brazilit” dhe Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Autoriteteve Veterinare Qendrore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Brazilit: – Lejohet importimi i mishit të gjedhit dhe mishit të shpendëve nga shtetet e Brazilit për në Republikën e Shqipërisë, prodhuar nga zona dhe stabilimente të miratuara nga BE, shoqëruar me certifikatë veterinare; dhe – Lejohet importimi i mishit të derrit nga shtetet e Brazilit për në Republikën e Shqipërisë, prodhuar nga stabilimente që përmbushin kërkesat e certifikatës veterinare të përcaktuar sipas Federatës Ruse.	02.09.2026	e plotë	nuk ka

		2. Sa është numri dhe sasia e ngarkesave/partive të importuara nga Brazili për secilën prej kategorive të mësipërme, të ndarë sipas viteve 2024, 2025 dhe 2026? 3. Cilat janë subjektet/operatorët e biznesit ushqimor në Shqipëri që kanë importuar produkte të mishit me vend origjine Brazil gjatë kësaj periudhe, si dhe kategoritë e produkteve të importuara prej tyre? 4. Cilat janë stabilimentet prodhuese ose eksportuese në Brazil nga të cilat kanë ardhur ngarkesat e mishit të destinuara për tregun shqiptar, për aq sa ky informacion administrohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit? 5. Sa është numri i ngarkesave që i janë nënshtruar kontrollit fizik, kontrollit dokumentar dhe/ose marrjes së mostrave laboratorike, të ndarë sipas viteve dhe kategorisë së produktit. 6. Nëse gjatë periudhës 2024-2026 janë konstatuar ngarkesa jokonforme të mishit me origjinë nga Brazili, informacion mbi: - numrin e rasteve - llojin e produktit - natyrën e jokonformitetit; - masën e marrë ndaj ngarkesës.	Nga verifikimet e kryera, rezulton se sasia e produkteve të mishit me origjinë nga Brazili që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, është si më poshtë: • Për vitin 2024, rezulton se janë importuar në total 13,409.178 ton mish nga Brazili, nga të cilat: mish pule në sasinë 6,265.650 ton; mish gjedhi në sasinë 691.359 ton; dhe mish derri në sasinë 6,452.170 ton. • Për vitin 2025, rezulton se janë importuar në total 12,522.47 ton mish nga Brazili, nga të cilat: mish pule në sasinë 6,727.1651 ton, mish gjedhi në sasinë 571.432 ton; dhe mish derri në sasinë 5,223.878 ton. • Për periudhën 01.01.2026 - 12.08.2026, rezulton se janë importuar në total 9,312.619 ton mish nga Brazili, nga të cilat: mish pule në sasinë 5,432.121.650 ton; mish gjedhi në sasinë 272.186 ton; dhe mish derri në sasinë 3,608.311 ton. Në përgjigje të pyetjes së dytë, lidhur me numrin dhe sasinë e ngarkesave të importuara nga Brazili për kategoritë e specifikuara në pyetjen e parë, nga verifikimet e kryera rezulton se: • Për vitin 2024, rezulton se janë importuar në total 512 ngarkesa me sasi totale 13409.178 ton mish nga Brazili, nga të cilat: 235 ngarkesa me mish pule në sasinë 6265.650 ton; 34 ngarkesa me mish gjedhi në sasinë 691.359 ton; dhe 243 ngarkesa me mish derri në sasinë 6452.170 ton; • Për vitin 2025, rezulton se janë importuar në total 475 ngarkesa me sasi totale 12522.47 ton		
--	--	--	--	--	--

		7. Në veçanti, kërkojmë informacion nëse gjatë kontrolleve laboratorike janë konstatuar mbetje të barnave veterinare, antibiotikëve, substancave antimikrobike apo substancave të tjera të kufizuara ose të ndaluara, si dhe, në rast se po, llojin e substancës së konstatuar dhe masën e marrë. Apo nëse janë gjetur produkte me origjinë shtazore të kontaminuara me <i>salmonelë</i> dhe <i>E.coli</i>.	mish nga Brazili, nga të cilat: 254 ngarkesa me mish pule në sasinë 6727.1651 ton; 23 ngarkesa me mish gjedhi në sasinë 571.432 ton; dhe 198 ngarkesa me mish derri në sasinë 5223.878 ton; • Për periudhën 01.01.2026 - 12.08.2026, rezulton se janë importuar në total 344 ngarkesa me sasi totale 9312.619 ton mish nga Brazili, nga të cilat: 207 ngarkesa me mish pule në sasinë 5,432.121.650 ton; 11 ngarkesa me mish gjedhi në sasinë 272.186 ton; dhe 126 ngarkesa me mish derri në sasinë 3608.311 ton. Në përgjigje të pyetjeve (3) dhe (4), subjektit të interesuar i vendoset në dispozicion lista e subjekteve & produktet sipas kategorizimit. Në përgjigje të pyetjes së pestë, nga verifikimet e kryera rezulton se: • Për vitin 2024, janë importuar në total 512 ngarkesa, nga të cilat: 235 ngarkesa me mish pule; 34 ngarkesa me mish gjedhi; dhe 243 ngarkesa me mish derri, kontroll dokumentar dhe identiteti 100% kontroll fizik 3.8% shoqëruar me marrje mostre 9; • Për vitin 2025, janë importuar në total 475 ngarkesa, nga të cilat: 254 ngarkesa me mish pule; 23 ngarkesa me mish gjedhi; dhe 198 ngarkesa me mish derri, kontroll dokumentar dhe identiteti 100% kontroll fizik 29.1% shoqëruar me marrje mostre 74; • Për periudhën 01.01.2026 - 12.08.2026, janë importuar në total 344 ngarkesa, nga të cilat: 207 ngarkesa me mish; 11 ngarkesa me mish		
--	--	--	--	--	--

				gjedhi; dhe 126 ngarkesa me mish derri, kontroll dokumentar dhe identiteti 100% dhe në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm, procedura e marrjes së mostrave kryhet në terren menjëherë me mbërritjen e ngarkesës në magazinën e subjektit për arsye të mungesës së infrastrukturës në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK). Në zbatim të Planit Vjetor Kombëtar të monitorimit të mbetjeve për produktet të ardhura nga importi, specifikisht (Brazil), janë marrë mostra në terren sipas viteve dhe kategorisë së produktit: • Për vitin 2024, rezulton se janë marrë në total 22 mostra mish pule dhe 12 mostra mish derri; • Për vitin 2025, rezulton se janë marrë në total 17 mostra mish pule dhe 8 mostra mish derri; • Për vitin 2026 (vijues), rezulton se janë marrë në total 17 mostra mish pule dhe 7 mostra mish derri. Në përgjigje të pyetjes së gjashtë, nga verifikimet e kryera, rezulton se përgjatë vitit 2024 nuk ka patur raste <i>Alert</i> nga Brazil. Ndërsa, përgjatë vitit 2025, rezultojnë 3 (tre) raste të tilla, konkretisht: <u>Rasti i parë:</u> • Lloji i produktit: Mish pule i ngrirë “<i>Kofsha pule me shpatulla të ngrira</i>”, importuar nga Brazil			
--	--	--	--	--	--	--	--

			• Substanca e identifikuar: “<i>Doxycycline</i>”, për treguesit e grupit A, A.3.c, Lëndët antimikrobike. • Masat e marra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit: Nga kontrollet e kryera rezultoi se sasia prej 2,700 kg kofshë pule, me datë skadence 13.09.2026, importuar nga Brazili, ishte shitur e gjitha tek konsumatori i fundit. Nga ana e subjektit, në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të tij, u vendos njoftimi për konsumatorët me qëllim kthimin e produktit të blerë, me datë skadence 13.09.2026. Kështu, në zbatim të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar), konkretisht në nenin 10, pika 2; nenin 12, pika 1, gërma ‘c’); dhe nenin 68, pika 1, gërma ‘d’) të tij, ndaj subjektit u mor masa administrative “<i>Gjobë</i>” në vlerën prej ALL 300,000 (treqind mijë lekë). • Shënim: Referuar këtij rasti <i>Alert</i>, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masa duke njoftuar edhe sistemin RASFF (sistemi për njoftimet alerte të shpejta të Bashkimit Evropian për ushqim dhe ushqim për kafshë) dhe INFOSAN. <u>Rasti i dytë:</u> • Lloji i produktit: Fileto derri e ngrirë, importuar nga Brazili • Substanca e identifikuar: Prania e <i>Salmonella spp</i> në 25g • Masat e marra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit: Nga kontrollet e kryera rezultoi se sasia prej 4516,75 kg fileto derri e ngrirë, me datë skadence 15.01.2026, ndodhej gjendje në			
--	--	--	---	--	--	--

			magazinën frigoriferike të subjektit. Ky produkt nuk ishte shpërndarë në treg. Referuar nenit 43, pika 2, gërma ‘ç)’ të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”, ndaj subjektit u mor masa urgjente “<i>Bllokimi dhe marrja në administrim e kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve</i>” duke u kryer bllokimi i sasisë prej 4516,75 kg e produktit “<i>Fileto derri e ngrirë</i>” me datë skadence 15.01.2026, rezultuar jo-konform mbi normën e lejuar të “<i>Salmonella spp</i>”. Subjektit iu la për detyrë marrja e masave për asgjësimin e produktit të lartëpërmendur. • Shënim: Referuar këtij rasti <i>Alert</i>, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masa duke njoftuar edhe sistemin RASFF (<i>sistemi për njoftimet alerte të shpejta të Bashkimit Evropian për ushqim dhe ushqim për kafshë</i>) dhe INFOSAN. • Përfundimi i rastit: Ky produkt është asgjësuar! <u>Rasti i tretë:</u> • Lloji i produktit: Fileto pule Coparol, importuar nga Brazili • Substanca e identifikuar: Prania e <i>Salmonella Typhimurium</i> në 25g • Masat e marra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit: Nga kontrollet e kryera rezultoi se nga sasia e importuar prej 10,272 kg fileto pule me datë skadence 13.12.2026, sasia totale e bllokuar e këtij produkti rezultoi në 8949.3 kg ndërsa diferenca prej 1,322.7.7 kg e produktit,			
--	--	--	---	--	--	--

			rezultoi të ishte shitur tek konsumatori. Kështu, referuar nenit 48, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”, për sasi të produktit “<i>Fileto Pule Copacol</i>”, të bllokuara në praktikën e inspektimit të çështjes nr.AKU-TR-2025-001 edhe ato të kthyera nga tregu, u vendosëm me destinacion asgjësimin, si produkt i pasigurt sipas kërkesave ligjore. • Shënim: Referuar këtij rasti <i>Alert</i>, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masa duke njoftuar edhe sistemin RASFF (<i>sistemi për njoftimet alerte të shpejta të Bashkimit Evropian për ushqim dhe ushqim për kafshë</i>) dhe INFOSAN. • Përfundimi i rastit: Ky produkt është asgjësuar! Së fundmi, për sa i përket vitit 2026 (vijues), deri më tani rezultojnë 2 (dy) raste të tilla, konkretisht: <u>Rasti i parë:</u> • Lloji i produktit: Mish pule i ngrirë “<i>Gjoks pule i ngrirë</i>”, importuar nga Brazili • Substanca e identifikuar: “<i>Doxycycline</i>”, për treguesit e grupit B1 a (A2d/A3c), Antimikrobikët e lejuar, Antimikrobikët e palejuar. • Masat e marra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit: Nga kontrollet e ushtruara rezultoi se e gjithë sasia prej 1,776 kg mish pule me datë skadence 19.01.2027, importuar nga Brazili, ishte tregtuar dhe nuk ishte në gjendje në			
--	--	--	---	--	--	--

			ambientin frigoriferik të subjektit. Po kështu, ky i fundit kishte mungesë të <i>sistemit të gjurmueshmërisë</i> në tregtimin e produktit. Kështu, në zbatim të neneve 25 dhe 68, pika 1, gërma ‘i’ të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar) si dhe VKM-së nr.760, datë 16.09.2015 “<i>Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor</i>”, ndaj subjektit u mor masa administrative “<i>Gjobë</i>” në vlerën prej ALL 100,000 (njëqind mijë lekë). Po kështu, në mbështetje të nenit 44, pikat 2, 5 dhe 6 të ligjit nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”, ndaj subjektit u mor masa administrative “<i>Paralajmërim</i>” dhe iu la për detyrë njoftimi i klientëve ku kishte kryer tregtimin e produktit (<i>sipas gjurmueshmërisë së pjesshme të vënë në dispozicion</i>), si dhe në rast kthimesh, të njoftonte Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë (DRAKU Tiranë). • Shënim: Referuar këtij rasti <i>Alert</i>, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masa duke njoftuar edhe sistemin RASFF (<i>sistemi për njoftimet alerte të shpejta të Bashkimit Evropian për ushqim dhe ushqim për kafshë</i>) dhe INFOSAN. <u>Rasti i dytë:</u> • Lloji i produktit: Mish pule i ngrirë “<i>Muskul pule</i>”, importuar nga Brazili • Substanca e identifikuar: “<i>Tilmicosin</i>”, për treguesit e grupit B1a (A2a/A2d/A3c),			
--	--	--	--	--	--	--

			Antimikrobikët e lejuar, Antimikrobikët e palejuar. • Masat e marra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit: Nga kontrollët e ushtruara rezultoi se e gjithë sasia prej 26,988 kg mish pule me datë skadence 12.02.2027, importuar nga Brazili, ishte e bllokuar në subjekt, në gjendje të izoluar në dhomë frigoriferike. Ky produkt nuk ishte shpërndarë në treg. Kështu, kjo sasi do të vazhdojë të qëndrojë e bllokuar në ambientet e subjektit me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”. Po kështu, në përputhje me nenin 44, pikat 2, 3, 5 dhe 6 të po këtij ligji, ndaj subjektit u mor masa administrative “<i>Paralajmërim</i>”, si dhe ky i fundit detyrohet të marrë masa për asgjësimin e produktit apo kthimin e tij në vendin e origjinës, deri më datë 24.07.2026, referuar nenit 69 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar) • Shënim: Referuar këtij rasti <i>Alert</i>, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masa duke njoftuar edhe sistemin RASFF (sistemi për njoftimet alerte të shpejta të Bashkimit Evropian për ushqim dhe ushqim për kafshë) dhe INFOSAN. • Përfundimi i rastit: Ky produkt u kthye në vendin e origjinës! <i>Në përgjigje të pyetjes së fundit</i>, në çdo rast konstatimi të jokonformitetit, kryhet njoftimi i menjëhershëm nga Laboratori në zbatim të pikës 11 të Kreut 1 “<i>Në fushën e sigurisë ushqimore</i>” të Urdhrit nr.24, datë 30.01.2013 “<i>Për unifikimin e</i>			
--	--	--	--	--	--	--

				<i>procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve” (i ndryshuar)¹. Mostrat janë të koduara nga inspektimi dhe për Sektorin e Koordinimit të Shërbimit Laboratorik, mbeten anonim.</i> Për sa më sipër, lidhur me jokonformitetet laboratorike për produktet me origjinë nga Brazili, rezulton se: Përgjatë vitit 2024 <u>nuk</u> ka patur produkte me origjinë nga Brazili. Përgjatë vitit 2025, rezultojnë 8 (tetë) raste të tilla, përkatësisht: • Total 5: 2 raste PIK-mikrobiologji, 3 raste terren 2 mikrobiologji dhe 1 mbetje veterinare; • Për 3 raste mikrobiologjike të analizuara në laborator të akredituar në BE, mostra të dorëzuara nga PIK DRAKU Durrës. Së fundmi, për vitin 2026 (deri më tani), rezultojnë 2 (dy) raste: terren – mbetje veterinare.			
115.	27.08.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me licencat, lejet dhe autorizimet e nevojshme për pajisjen me dokumentacionin përkatës, me qëllim ushtrimin e aktivitetit të tregtimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nëpërmjet dispenservëve të ujit.	Çdo subjekt që kryen veprimtari me natyrë ekonomike jovetjake në fushën e ushqimit “prodhim dhe/ose tregtim të ushqimeve”, duhet të regjistrohet dhe licençohet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.	28.08.2026	e plotë	nuk ka

¹ Në rastin e marrjes së rezultateve të analizave jo në përputhje me normat e vendosura në legjislacionin në fuqi, AKU njofton menjëherë DPSUMK (MBZHR) dhe ISUV. Në rastin kur këto rezultate janë marrë gjatë analizimit të mostrës së produktit ushqimor në ISUV, ky i fundit njofton menjëherë DPSUMK (MBZHR) dhe AKU. Në këtë rast, njoftimi bëhet me shkresë zyrtare dhe në rrugë elektronike për Drejtorin e DPSUMK dhe Përgjegjësit e Sektorëve.

			Subjektet që kryejnë veprimtari <u>me pakicë</u> nuk licencohen, por këto subjekte janë të detyruara që të kryejnë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të njoftojnë Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) përkatës, për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë (<i>“Subjektet që kryejnë veprimtari me pakicë lidhur me nënkategoritë A dhe B e që kupton subjektet e regjistruara si pagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël nuk licencohen. Këto subjekte janë të detyruara të njoftojnë autoritetet e përmendura si institucion tjetër lidhur me nënkategoritë A dhe B për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë”</i>). Në mbështetje të VKM-së nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” (i ndryshuar), për licencat e grupit të tretë (që i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit); Fusha II, Ushqimi dhe Shëndeti, Kategoria II.I, Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, subjekti nuk ka detyrim ligjor të pajiset me licencë në veprimtarinë e shitjes së këtyre produkteve, referuar natyrës së tyre me origjinë joshitazore.			
--	--	--	---	--	--	--